



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

## INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS ME TRANSMETUESIN PUBLIK SHQIPTAR RTSH

*Transmetuar më 9 shkurt 2021*

*Dhënë gazetarit Lutfi Dervishi, në emisionin "Përballë"*

**Z. Ambasador, Shqipëria kishte kryesinë e OSBE-së gjatë vitit 2020. Cili është vlerësimi juaj për këtë Kryesi, duke pasur parasysh që 2020 ishte një vit krejt i pazakontë me Covid-19?**

**Ambasadori Del Monaco:** Kryesia shqiptare e radhës ishte shumë produktive, me gjithë rrethanat e vështira dhe, sikurse e thatë, këtë vit shumë të pazakontë. Në fakt, do ta quaja një vit shumë të vështirë, për shkak të kovidit. Kovidit goditi fort, vijon të godasë fort, dhe unë dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për t'u shprehur ngushëllimet e mia të gjithë shqiptarëve që kanë humbur njerëzit e tyre të dashur për shkak të pandemisë.

Dialogu dhe angazhimi i vazhdueshëm u mishëruan në Kryesinë e Radhës të Shqipërisë. Kjo u reflektua qartë në nivelin e takimit të Këshillit Ministror, që u zhvillua në Tiranë, 3 dhjetorin e shkuar. Do të përmendja 8 vendimet e miratuara, 2 deklaratat dhe një deklaratë ministrore. Ishte një rezultat shumë bujar. Më lejoni të nënvizoj se aftësitë diplomatike të Shqipërisë bënë të mundur caktimin e Sekretares së Përgjithshme të OSBE-së dhe të drejtuesve të tri institucioneve të pavarura të OSBE-së. Gjithashtu, Shqipëria kontribuoi edhe në forcimin e luftës kundër korrupsionit, përmes dixhitalizimit dhe rritjes së transparencës. Ka edhe arritje të tjera që nuk do t'i përmend, pasi lista do të ishte shumë e gjatë, por, sa për të thënë një shembull tjetër: kërcënimet transnacionale. Do të nënvizoj edhe një pikë tjetër, që, në mendimin tim, është shumë e rëndësishme: kontributi i Kryesisë së Radhës nga Shqipëria në marrëdhëniet e mira me fqinjët. Kjo pasi Shqipëria lehtësoi vendimin kolektiv për t'ia besuar Maqedonisë së Veriut kryesinë e OSBE-së për vitin 2023. Ideja është që nuk ka rëndësi se sa i vogël apo i madh është një vend: ne të gjithë duhet të kontribuojmë për sigurinë evropiane dhe kjo është ajo që Maqedonia e Veriut do të bëjë në vitin 2023. Edhe një arritje tjetër që ka të bëjë me funksionimin e brendshëm të organizatës: pavarësisht rolit pengues të kovidit, OSBE-ja arriti të funksionojë më së mirë gjatë vitit 2020.

**Me këtë listë të gjatë arritjesh, ndoshta pyetja do të ishte më e saktë që nëse s' do të kishim kovidin, ndoshta do të kishim bërë mrekullinë. Megjithatë, stafeta tashmë është në duart e presidencës suedeze. Cilat janë përparësitë e presidencës suedeze për OSBE-në?**

**Ambasadori Del Monaco:** Siç u njoftua nga ministrja e Jashtme suedeze, Stokholmi do t'i japë përparësi kontributit të mëtejshëm në sigurinë evropiane, mbështetjes së konceptit të OSBE-së për një siguri gjithëpërfshirëse, kontributit në zgjidhjen e konflikteve në zonën e OSBE-së, forcimit të barazisë gjinore edhe përmes axhendës Gratë, Paqja dhe Siguria, si edhe promovimit të shoqërisë civile në diskutimet për sigurinë. Ideja kryesore është që siguria politike dhe ekonomike, të drejtat e njeriut, demokracia, janë të gjitha të ndërlidhura dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën. Mesazhet e paraqitura nga Kryesia suedeze forcojnë idenë se qasja shumëpalëshe ndaj sfidave të përbashkëta është e një rëndësie parësore.

**Nëse rikthehemi te sfidat në Shqipëri, cili do të jetë fokusi i punës suaj?**

**Ambasadori Del Monaco:** Prezenca do të bëjë më të mirën duke u përpjekur të “përkthejë” në nivelin vendor, këtu në Shqipëri, përparësitë e përcaktuara nga Kryesia suedeze. Ne do të trajtojmë çështje që kanë lidhje me sigurinë, padyshim, duke nisur nga kërcënimet transnacionale. Më lejoni t’ju kujtoj se Covid-19 është shembulli më i mirë i kërcënimit transnacional. Edhe në fushën e masave në mbështetje të Shqipërisë gjatë pandemisë, Prezenca luajti një rol shumë aktiv dhe falënderimet u shkojnë paraardhësit tim dhe kolegëve, pasi unë nuk kisha mbërritur ende. Ne do t’i japim rëndësi edhe dimensionit të qeverisjes, si një mënyrë për trajtimin e çështjeve të sigurisë mjedisore dhe korrupsionit. Pastaj kemi edhe fushat në të cilat Prezenca njihet për rolin e saj udhëheqës: do të përmendja procesin zgjedhor, median, barazinë e të drejtave mes burrave dhe grave, bashkëpunimin e gjatë me Kuvendin e Shqipërisë dhe edhe me Gjykatën Kushtetuese, tashmë funksionale. Në vizionin tim, përparësi u duhet dhënë edhe të rinjve dhe, për sa të jetë e mundur, komponentit rajonal. Të gjitha këto përparësi do të përkthehen në programe që ne do t’i vëmë në dispozicion të Shqipërisë dhe programet tona, idetë tona, objektivat tona janë fryt i partneritetit të përditshëm krah për krah me Shqipërinë, institucionet shqiptare, median dhe shoqërinë civile.

**Z. Ambasador, të flasim për këto prioritete që ju përmendët: procesin zgjedhor, median, drejtësinë, Gjykatën Kushtetuese. Zgjedhjet janë thembra e Akilit e demokracisë shqiptare. Sa herë kanë shkuar zgjedhjet mirë, çdo gjë ka shkuar mirë dhe, sa herë që zgjedhjet kanë shkuar keq, vendi ka vuajtur, ka pësuar regres në shumë fusha. Në gjykimin tuaj, shikoni ndonjë rrezik për zgjedhjet e 25 prillit, që tashmë janë shumë afër?**

**Ambasadori Del Monaco:** Falemnderit për këtë pyetje shumë të rëndësishme. Unë do t’ju përgjigjem më mënyrë shumë të drejtpërdrejtë: që kur mora detyrën në Tiranë nuk kam vënë re ndonjë zhvillim që do të përlligjte të folurit për një rrezik në vetvete. Natyrisht që ka sfida, por sfidat i përkasin çdo procesi zgjedhor, veçanërisht kur një vend zbaton për herë të parë rregulla të reja dhe kur koha nuk është domosdoshmërisht e gjatë deri ditën e zgjedhjeve. Prezenca përveshi mëngët: ne kemi punuar shumë mirë me KQZ-në, bashkëpunojmë me Policinë e Shtetit dhe, sikurse keni parë, kemi filluar disa nisma që nga trajnimi i policisë që do të shtrihet në 6 mijë punonjës policie; para pak ditësh festuam Ditën Botërore të Zgjedhjeve me Komisionerin Shtetëror z. Celibashi duke u fokusuar te të rinjtë; dhe kemi gati disa nisma të tjera që shtrihen nga veprimtari informative për grupe vulnerabël, të rinjtë, trajnime për median. Tani për tani, nuk shoh ndonjë gjë që do të më bënte të flisja për ndonjë rrezik të mundshëm. Pastaj, sikurse e dini, vlerësimi i zgjedhjeve dhe institucioni që do ta shoqërojë më nga afër Shqipërinë gjatë zgjedhjeve është ODIHR-i, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Nga ana ime, unë veç mund të besoj se po përgatitemi për një kremtim të gëzuar të zgjedhjeve, duke besuar se kjo do të shënojë edhe fundin e fushatës politike.

**Z. Ambasador, ju e përmendët që këto zgjedhje zhvillohen nën disa kushte të reja dhe përmendët që ka rregulla të reja që kanë rrjedhur si rezultat i marrëveshjes së 5 qershorit apo i ndryshimeve të mëvonshme kushtetuese. Flitet për teknologjinë, flitet për mundësinë e votës së emigrantëve dhe kufizimin e mëtejshëm të përdorimit të burimeve njerëzore nga administrata gjatë kësaj periudhe dhe kjo rrjedh nga marrëveshja e 5 qershorit. Nga sa ju thatë, më dukeni se jeni i vetmi person optimist në Tiranë se zgjedhjet do të shkojnë mbarë.**

**Ambasadori Del Monaco:** Jam person optimist për nga natyra. Po të mos isha person optimist, nuk do të isha në këtë punë. Në Mesjetë, disa filozofë mendonin se bota jonë është një botë e përkryer. Filozofi i madh gjerman Leibniz e çoi në një nivel më të lartë sofistikimi nocionin që

bota jonë është e përkryer. Për të qenë me këmbë në tokë, unë jam person optimist sepse unë besoj në demokracinë shqiptare dhe besoj fort se demokracia është sistemi i përsosur, një sistem i përsosur që ka vend për t'u përsosur gjithmonë më tej. Kemi rregulla të reja - ky është një fakt; zgjedhjet janë afër – ky është një fakt tjetër, por, për sa mund të shoh, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po punon fort dhe ka një ndërgjegjësim të përgjithshëm për afatet e ngushta deri më 25 prill. Këto e përforcojnë instinktin tim optimist të natyrshëm. Ndoshta mund ta shfrytëzoj këtë rast për të shtuar se zbatimi i plotë i dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor do të kërkojë edhe një përpjekje të përbashkët nga institucionet, nga udhëheqësit politikë dhe madje edhe nga secili qytetar, pasi ata që kanë dokumente identifikimi të skaduara duhet të nxitojnë dhe të aplikojnë për karta të reja identiteti.

**Z. Ambasador, ju jeni ambasadori i nëntë i OSBE-së në Tiranë. Unë si gazetar kam ndjekur 9 zgjedhje parlamentare dhe gjithmonë para fushatës ka një optimizëm, sidomos te ndërkombëtarët, se gjërat do të shkojnë mirë. Ju keni pasur takime intensive ditët e fundit me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe me aktorë të tjerë. Cila mendoni se është sfida më e madhe që kanë institucionet shqiptare në këto zgjedhje?**

**Ambasadori Del Monaco:** Koha. Koha për mua është ndoshta një prej sfidave më të mëdha që shoh. Kjo pasi do të duhet të siguroheni që dispozitat e reja të zbatohen në një afat kohor relativisht të shkurtër. Pastaj ekzistojnë natyrisht edhe disa sfida të tjera: njëra prej tyre është vota e emigrantëve. Unë kam një përvojë të drejtpërdrejtë në këtë fushë, pasi në detyrën e mëparshme kam pasur mundësinë të organizoja votën e italianëve në shtetet ku shërbeja, dhe e di nga përvoja ime se sa komplekse mund të jetë. Edhe aplikimi i teknologjisë është sfida në vetvete për zgjedhjet e reja. Unë ia shtoj zërin tim zërit të autoriteteve shqiptare, të udhëheqësve politikë dhe të kolegëve të mi të bashkësisë ndërkombëtare, duke u bërë thirrje qytetarëve shqiptarë që të rinovojnë sa më shpejt kartat e identitetit, pasi kjo është absolutisht themelore. Pra, do të thosha që koha dhe fondet në dispozicion të KQZ-së janë pika kyçe që do të duhet të trajtohen deri në fund.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është partner afatgjatë i zyrës së OSBE-së në Tiranë, por, me ndryshimet në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor, ka ndryshuar edhe struktura dhe kompetencat e këtij Komisioni. Cila është asistenca konkrete që ju po i jepni Komisionit sot?**

**Ambasadori Del Monaco:** Faleminderit që sillni në vëmendje bashkëpunimin për një kohë të gjatë që Prezenca ka me KQZ-në. Ne kemi filluar duke i dhuruar KQZ-së një mijë kopje të Kodit Zgjedhor. Para pak ditësh, ia dhashë personalisht kopjen e parë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Celibashi. Së bashku, organizuam Ditën Botërore të Zgjedhjeve, me fokus të rinjtë, duke dhënë mesazhin se aktivizimi politik i të rinjve është një aset për demokracinë shqiptare. Do të kemi edhe disa aktivitete: disa spote televizive, informacione që do të qarkullohen në internet dhe në mediat sociale; do të merremi edhe me grupet vulnerabel, personat me vështirësi në shikim, pakicat dhe, paralelisht, siç e përmenda, punojmë krah për krah me Policinë e Shtetit dhe me median.

**Z. Ambasador, pas çdo zgjedhjeje parlamentare apo lokale, si rregull, ne kemi një sërë rekomandimesh të reja nga ODIHR-i. Nga bisedat që ju keni pasur me stafin tuaj, a presim sërish një listë tjetër rekomandimesh pas 25 prillit?**

**Ambasadori Del Monaco:** Ky është një hamendje. Është absolutisht e parakohshme dhe nuk ka asgjë që do të më bënte të spekuloja mbi një hamendje. Do të duhet të procedojmë me shpejtësi dhe do të shohim pas zgjedhjeve nëse do të ketë ndonjë rekomandim nga ODIHR-i.

**Një nga rekomandimet e vjetra konsistente të OSBE/ODIHR-it ka qenë që të shikohet mundësia e depolitizimit të komisioneve qendrore. Për shkak të mosbesimit të thellë mes palëve në Shqipëri, zgjedhjet kontrollohen nga partitë politike. Kur mendoni se Shqipëria do të jetë e gatshme të heqë dorë nga kontrolli politik mbi strukturat zgjedhore?**

**Ambasadori Del Monaco:** Keni të drejtë. ODIHR-i ka advokuar për depolitizimi e proceseve zgjedhore. Nëse e kuptoj drejt, sipas marrëveshjes së qershorit, do të ketë një depolitizim progresiv të procesit duke filluar nga zgjedhjet e 2024-s.

**Një tjetër problem që ka shoqëruar së fundmi zgjedhjet shqiptare dhe ka ndikuar në debatin politik në mjedisin parlamentar ka qenë zbatimi i ligjit të dekriminalizimit. Ju e dini që kjo është një çështje e nxehtë në Tiranë. Në bisedat me aktorët politikë në Shqipëri a keni marrë zotime prej tyre se lista e kandidatëve për deputetë këtë radhë do të jetë e pastër?**

**Ambasadori Del Monaco:** Sërish, edhe kjo është një temë shumë e rëndësishme dhe ne filluam ta trajtojmë atë që në dhjetor, kur sapo kisha marrë detyrën. Së bashku me ambasadoren holandeze organizuam një aktivitet për zbatimin e ligjit të dekriminalizimit. E them këtë për t'ju treguar rëndësinë që i kemi dhënë gjithmonë kësaj çështjeje. Mendoj se ka të paktën dy hapa ligjorë, të cilët mund të mblidhen nën një qasje të përgjithshme. Hapi i parë është përgjegjësia ligjore e individit që plotëson formularin e vetëdeklarimit dhe kjo është përgjegjësia personale ligjore e këtij personi. Pastaj është hapi i dytë ligjor, pasi kjo listë do të duhet të verifikohet nga KQZ-ja dhe nga Prokuroria e Përgjithshme. Ajo që shoh është se partitë politike nuk janë caktuar as në periferi të këtij debati shumë të rëndësishëm, ku mund të shikohet shkëmbimi i ideve mes drejtuesve politikë në këtë debat sensitiv. Është e rëndësishme kjo, pasi duhet të jemi konsistentë: hapa ligjorë - mesazhe politike. Në fund të fundit, kjo është një sekuencë që fillon me përgjegjësinë individuale të kandidatit të mundshëm dhe përfundon me një listë të papërlyer.

**Megjithatë, në këtë takim të rëndësishëm, përfaqësuesi i Prokurorisë tha se ligji, sado i ashpër që është, nuk e ka stepur apo nuk e ka ulur dëshirën e njerëzve me të kaluar problematike për të kandiduar. Po ju kujtoj që së fundi ju keni pasur një takim edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe policia ka një rol të rëndësishëm për të penguar ndikimin e krimit të organizuar në zgjedhje, për të parandaluar rastet e shitblerjes së votës. Çfarë keni ndier, nuk po them garanci, por çfarë ndjeshmërisht keni pasur që policia do të jetë aktive për të parandaluar dhe për të ndërhyrë në kohë në çdo fenomen që dëmton procesin elektoral?**

**Ambasadori Del Monaco:** Në fakt, kam pasur dy takime me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe në të dyja rastet u ktheva në Prezencë me një ndjenjë pozitive. Policia nuk duhet të më garantojë mua ndonjë gjë. Por isha shumë i lumtur, dhe mund ta ndaj këtë gjë me ju dhe me të gjithë shqiptarët që po na ndjekin nga shtëpia, se policia është e gatshme të bëjë më të mirën për të kontribuar në organizimin e këtij kremtimi të demokracisë më 25 prill. Nga ana jonë, si Prezencë, ne kemi filluar trajnimin e policisë dhe së shpejti do të shpërndajmë një version të përditësuar të një broshure me udhëzimet thelbësore për menaxhimin e rendit publik në kohë zgjedhesh.

**Ndërkohë që flasim për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në Shqipëri, zgjedhjeve që nuk do të kontestohen, ka ndodhur një ngjarje sizmike në atë që quhet hapësira demokratike e botës që jetojmë. Çfarë mendoni, ç'ndikim kanë për Shqipërinë dhe jo vetëm për Shqipërinë ngjarjet shokuese të 6 janarit në SHBA, që lidhen me zgjedhjet presidenciale dhe me kontestimin e tyre atje?**

**Ambasadori Del Monaco:** Kam frikë se pyetja juaj nënkupton një njohje të thellë të dinamikave të Shqipërisë, por kam frikë se jam tepër i ri në Shqipëri për t'ju dhënë një përgjigje josipërfaqësore. Ajo që mund të them në terma shumë të përgjithshëm është se për mua është e qartë që demokracia nuk është e lehtë dhe nuk duhet të merret si e mirëqenë nga asnjë prej nesh. Nëse mund të parafrazoj atë që ka thënë një herë Jacques Delors lidhur me procesin e integritimit në BE, demokracia është si të ngasësh biçikletën: nëse ndalon së pedaluari, mund të biesh. Është një kantier ndërtimi i hapur.

**Mosmarrëveshjet e forta elektorale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u adresuan nga gjykata, edhe kërcënimi ishte që do ta çoj çështjen në gjykatë. Mosmarrëveshjet e mundshme këtu janë pak më delikate për shkak se sistemi gjyqësor është duke u reformuar ende dhe në çdo mosmarrëveshje është gjithnjë e nevojshme prania e një arbitri. Këtë rol këtu e kanë luajtur shpesh ndërkombëtarët dhe ambasadorët. Shihni për veten tuaj dhe për kolegët tuaj rol në këto zgjedhje në rast mosmarrëveshjeje?**

**Ambasadori Del Monaco:** Reformat janë një zhvillim tjetër pozitiv në këtë vend. Unë nuk i shoh reformat si mangësi në sistem. Pra unë i përshtes dhe inkurajoj akoma më shumë reforma demokratike. Do të parapëlqejja të përcillja një mesazh besimi: besoni në institucionet shqiptare, besoni në gjyqësorin shqiptar, besoni në demokracinë tuaj. Unë flas në emër të Prezencës dhe Prezenca nuk do të jetë kurrë arbitër, ne nuk jemi arbitër. Nuk mendoj se Shqipëria ka nevojë për një arbitër. Duhet thjesht të zbatoni ligjet dhe të besoni te gjyqtarët tuaj, pasi këto çështje do të zgjidhen nga gjyqtarët që kanë kaluar vetingun, në Kolegjin Zgjedhor.

**Z. Ambasador, është krijuar një traditë në Shqipëri që partitë politike dhe kandidatët në garë, gjithnjë e më tepër, raportojnë veten në proceset zgjedhore duke anashkuar, injoruar dhe shpesh edhe mënjano gazetarët. Si e sheh rolin e medias në përballje me këtë fenomen negative?**

**Ambasadori Del Monaco:** Kolegët më kanë informuar për këtë praktikë dhe e di që fenomeni është kritikuar edhe nga ODIHR-i, pasi mund t'i keqorientojë zgjedhësit dhe të ndërhyjë edhe në lirinë e medias. Personalisht, unë mbështetem te media për një informacion publik që jepet nga media dhe që është i saktë, profesional dhe i paanshëm. Për t'ju treguar se sa e çmoj punën tuaj, e cila është tejet sensitive, sidomos në periudhë zgjedhore, do t'ju kujtoja se aktiviteti i parë ku mora pjesë në Shqipëri kishte lidhje me median dhe edhe fakti që sot pranova ftesën tuaj për të shkëmbyer këndvështrimet tona, më pak se tre muaj nga marrja e detyrës, duke sfiduar disi edhe forcën e rëndesës, dëshmon respektin që kam për punën tuaj, për pritshmëritë e publikut dhe nevojën që të ketë transparencë dhe shkëmbim këndvështrimesh.

**Z. Ambasador, pak më parë ju thatë që një nga prioritetet e punës tuaj është liria e medias dhe OSBE-ja e mbështet lirinë dhe pavarësinë e medias. Së fundmi kemi edhe Komisionerin për Lirinë e Medias në zonën e OSBE-së. Pyetja është çfarë shikoni ju si rrezik për lirinë e medias në Shqipëri.**

**Ambasadori Del Monaco:** Liria e medias ka treguar progres të mirë. Ka ende çështje, me sa kuptoj, që duhet të zgjidhen. Kam lexuar për faktin që gazetarët herë pas here punojnë nën presion, disa herë pa kontratë të duhur dhe e kuptoj si qenie njerëzore se kur punon në një situatë të vështirë mund të mos jesh mjaftueshëm i guximshëm për të shkruar apo për të komunikuar mendimet e tua dhe për të transmetuar informacion krejtësisht të paanshëm. Gjithashtu, kam lexuar nga opinioni i Komisionit të Venecias për lidhjen politike të disa mediave. Nga ana tjetër, e vlerësoj zhvillimin e fundit që tregon shenja të një kulture të shëndetshme mediatike – i referohem rastit të “Faktoje”, medias së pavarur që fitoi një çështje gjyqësore kundër një institucioni publik së fundmi. Ky është një rezultat i rëndësishëm që përforcon përsëri optimizmin tim dhe inkurajimin për t’u besuar institucioneve shqiptare. Sigurisht, jam i vetëdijshëm për ndryshimet e propozuara në ligjin e ri të medias dhe qëndrimet e OSBE-së përmes institucionit të Përfaqësuesit të Lirisë së Medias dhe të Komisionit të Venecias janë të mirënjohura, por edhe aty ka disa çështje që mbeten për t’u zgjidhur, ndërsa të tjera janë përfshirë tashmë në sekuencën e projektdispozitave që u shkëmbyen si me Përfaqësuesin e Lirisë së Medias edhe me Komisionin e Venecias.

**Z. Ambasador, ju përmendët si arritje faktin që një grup mediatik që bën fact-checking arriti që, nëpërmjet vendimit të gjykatës, të marrë të drejtën që ia jep ligji për informimin e publikut me dokumentet zyrtare. Megjithatë, doja t’ju pyesja sa të kënaqur jeni ju me reagimin e autoriteteve ndaj rasteve të dhunimit të gazetarëve apo të pengimit të tyre në kryerjen e punës, siç ka qenë edhe rasti i protestave të fundit në dhjetor në Tiranë?**

**Ambasadori Del Monaco:** Nuk jam unë që duhet të jem i kënaqur.

**I zemëruar.**

**Ambasadori Del Monaco:** Jo, as i kënaqur, as i zemëruar. Prezenca nuk është këtu për të kërkuar kënaqësi nga institucionet shqiptare dhe nuk jam në pozicion për të gjykuar këto pretendime. Ajo që do të doja të thosha është e qartë dhe ka dy aspekte: këta gazetarë që besojë se iu janë shkelur të drejtat duhet të paraqesin një ankesë te gjyqësori shqiptar, kështu funksionon demokracia; dhe, nga ana tjetër ne ia shprehëm edhe Policisë së Shtetit parimet e mirënjohura të vetëpërbajtjes, të përdorimit të taktikave të kontrollit të turmës në përpjesëtim me natyrën e ngjarjes, dhe për të mos e penguar kurrë punën profesionale të gazetarëve.

**Pak më parë ju përmendët që tashmë po bëni gati tre muaj në Shqipëri dhe sot flitet për rrezikun e teorive konspirative, fake-news. Sa e shihni këtë rrezik për median, klasën politike dhe eventualisht për shoqërinë?**

**Ambasadori Del Monaco:** Mohimi, teoritë e konspiracionit, lajmet e rreme paraqesin një sfidë shumë serioze në mos kërcënim për mbarë botën, nuk është diçka specifike për mjedisin shqiptar. Të gjitha ato janë kërcënime potenciale për sigurinë. Si fillim, do të thosha se interneti është një oqean informacioni dhe neve na duhet busulla për të lundruar si duhet në këtë oqean. Kjo busull nuk jepet domosdoshmërisht përmes kufizimeve – ndonjëherë është e kotë pasi është tepër i madh për t’u kufizuar – por me një përpjekje të përbashkët që nis nga familja, nga shkolla, nga media vetë, duke e edukuar popullatën që të heqë një vijë ndarëse midis asaj që është e vërtetë dhe asaj që është e rreme. Kjo është ajo që quhet rezistenca e një kombi, që është një element themeltar i sigurisë kombëtare. Dhe, meqë kjo është një çështje që ka lidhje me sigurinë, Prezenca është aktive edhe në këtë fushë. Prandaj kemi programe bashkë me

Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës pikërisht për lajmet e rreme, si edhe me transmetuesin publik.

**Z. Ambasador, një tjetër fokus i punës suaj që përmendët në fillim ishte Gjykata Kushtetuese. Ka pasur një entuziazëm të dukshëm, sidomos nga ana e ndërkombëtarëve në Tiranë, që më në fund Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, pas dy vjet pezullimi u bë funksionale. Por ne jemi të ndërgjegjshëm që ajo që quhet reformë në drejtësi është ende larg së quajturit e përfunduar. Në mungesë të një gjykate funksionale – e ripërsëris këtë pyetje – si mendoni se do të zgjidhen mosmarrëveshjet e mundshme zgjedhore?**

**Ambasadori Del Monaco:** Keni të drejtë dhe zgjodhët emrin e duhur: entuziazëm. Në krah të këtij emri unë do të shtoja edhe mbiemrin racional. Pasi është me entuziazëm racional që pamë me kënaqësi të madhe që Gjykata Kushtetuese është funksionale. Ky është një institucion që shërben si gur themeli për funksionimin e çdo sistemi demokratik, jo vetëm në Shqipëri. Në fakt, e vizitova Gjykatën po atë ditë që u zgjodhën gjyqtarët e rinj dhe ishte një takim shumë i frytshëm me Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese. Për të ardhur në temë, vetëm gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e mundshme pas zgjedhjeve. Gjykata Kushtetuese nuk do të ketë rol në këtë, përveçse nëse ndodhin dy hipoteza: dhunimi i të drejtave të njeriut, nëse paraqitet ndonjë ankesë, dhe mosfunksionimi i duhur i procesit të ligjit. Përndryshe, mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen nga gjyqtarët në Kolegjin Zgjedhor që e kanë kaluar vetingun.

**Fund**